

UDHËRRËFYES

PËR NJË ZGJIDHJE TË QËNDRUESHME PËR ZOTËRIMIN E PALIGJSHËM, KEQPËRDORIMIN DHE TRAFIKIMIN E ARMËVE TË VOGLA DHE TË LEHTA (AVL) DHE MUNICIONEVE TË TYRE NË BALLKANIN PERËNDIMOR, BRENDA VITIT 2024.

SEESAC

This project is funded by the European Union

german cooperation
DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT

Liberté • Égalité • Fraternité
RÉPUBLIQUE FRANÇAISE

RegionalCooperationCouncil

UDHËRRËFYES

PËR NJË ZGJIDHJE TË QËNDRUESHME PËR ZOTËRIMIN E PALIGJSHËM, KEQPËRDORIMIN DHE TRAFIKIMIN E ARMËVE TË VOGLA DHE TË LEHTA (AVL) DHE MUNICIONEVE TË TYRE NË BALLKANIN PERËNDIMOR, BRENDA VITIT 2024.

PËRKTHIM JOZYRTAR

Nën kujdesin e Ministrisë Federale të Punëve të Jashtme të Gjermanisë, Bashkimit Evropian dhe Këshillit për Bashkëpunim Rajonal, në datën 1 shkurt 2018, SEESAC organizoi në Podgoricë, Mali i Zi, një Takim Rajonal të Nivelit të Lartë me Zëvendësministrat e Brendshëm dhe Zëvendësministrat e Punëve të Jashtme nga Tirana, Sarajeva, Prishtina, Kishinjev, Podgorica, Beogradi dhe Shkupi[1].

Takimi risolli në vëmendje angazhimin e qartë politik të të gjithë aktorëve në rajon në drejtim të rritjes së kontrollit dhe ndalimit të përhapjes së armëve të vogla, gjë e cila u konfirmua nëpërmjet miratimit të një Deklarate të Përbashkët. Më tej, duke pranuar se përhapja dhe trafikimi i paligjshëm i armëve të zjarrit dhe municioneve të tyre është një kërcënim i vazhdueshëm për sigurinë e brendshme, autoritetet në rajon u angazhuan për të hartuar një **"Udhërrëfyes[2] për një zgjidhje të qëndrueshme për zotërimin e paligjshëm, keqpërdorimin dhe trafikimin e Armëve të Vogla dhe të Lehta (AVL)/armeve te zjarrit dhe municioneve të tyre në Ballkanin Perëndimor" (Udhërrëfyesi)**.

Qëllimi i këtij Udhërrëfyesi është që të shërbejë si një dokument udhëzues dhe konsensual i përgatitur dhe në pronësi të autoriteteve rajonale, për gjetjen e një zgjidhjeje të qëndrueshme për çështjen e mbajtjes, keqpërdorimit dhe trafikimit të paligjshëm të armëve të vogla dhe të lehta (AVL)/armeve e zjarrit dhe municioneve të tyre në Ballkanin Perëndimor. Ky dokument dëshmon konsensusin e arritur ndërmjet palëve të interesuara në rajon për sfidat aktuale, objektivat e përgjithshëm që synohen të arrihen dhe kalendarin e veprimeve që duhet të ndërmerren. Ai siguron një platformë të përgjithshme për nivelet e zbatimit të aktiviteteve të miratuara bashkërisht dhe parashtron angazhimin në nivel strategjik, politikash dhe operacional që kërkohet nga përfituesit, mbështetur në angazhimin politik në *Programin e Veprimit të Kombeve të Bashkuara për Parandalimin, Luftën dhe Asgjësimin e Tregtisë së Jashtëligjshme të Armëve të Vogla dhe të Lehta në të gjitha Aspektet e tij,* si dhe në detyrim ligjor që buron nga *Protokolli kundër Prodhimit të Paligjshëm dhe Trafikimit të Armëve të Zjarrit, Pjesëve të tyre, Komponentëve dhe*

[1] Ky dokument trajton armët e zjarrit për civilët dhe ato për përdorim ushtarak. Termi "armë të vogla dhe të lehta" (ALV) përdoret kur bëhet fjalë për armë për përdorim ushtarak dhe termi "armë zjarri" përdoret me qëllim për të përfshirë edhe armët e zjarrit për civilët. Armët e zjarrit dhe AVL përdoren për të mbuluar të gjithë shtrirjen e tyre. Për qëllimin e këtij dokumenti, Armët e Vogla dhe të Lehta përkufizohen sipas përkufizimit të ofruar nga Paneli i Ekspertëve Qeveritarë të OKB-së 1997 (www.un.org), ndërsa termat "armë zjarri" dhe "municione" përkufizohen në përputhje me Direktivën e Këshillit të BE-së 91/477/KEE "Për kontrollin e blerjes dhe mbajtjes së armëve". Lëndët plasëse përkufizohen sipas përkufizimit të parashikuar nga Udhëzimet Teknike Ndërkombëtare për Municionet.

[2] Megjithëse autoritetet nga Kishinjev iu bashkuan menjëherë deklaratës së përbashkët dhe elementeve të miratuara të Udhërrëfyesit, ata nuk janë pjesë e Ballkanit Perëndimor dhe për këtë arsye nuk janë përfshirë në Procesin e Berlinit. Megjithatë, në interes të progresit të mëtejshëm të procesit për anëtarësim në BE, autoritetet moldave shprehën gatishmërinë e tyre për të ndjekur nga afër zbatimin e Udhërrëfyesit dhe për të strukturuar dokumentat e tyre strategjike dhe politikat në përputhje me këtë Udhërrëfyes.

Municioneve (Protokolli për Armët e Zjarrit). I bazuar në Procesin e Berlinit[3] , zbatimi i Udhërrëfyesit do të lehtësojë më tej përpjekjet e Ballkanit Perëndimor për të përmbushur disa nga kushtet e sigurisë që janë kyçe për anëtarësimin e plotë në BE, siç përcaktohet në Komunikatën e re të KE-së për **"Një perspektivë të besueshme zgjerimi dhe për rritjen e angazhimit të BE-së me Ballkanin Perëndimor"**, në Planin e Veprimit, që gjendet bashkëngjitur, **në mbështetje të transformimit të Ballkanit Perëndimor, Strategjinë e BE-së 2005 për luftën kundër akumulimit dhe trafikimit të paligjshëm të armëve të vogla dhe të lehta dhe municioneve të tyre** dhe **Planin e Veprimit për trafikimin e paligjshëm të armëve të zjarrit** ndërmjet BE-së dhe rajonit të Evropës Juglindore 2015-2019[4]. Përveç kësaj, ai do të kontribuojë drejtpërdrejt në zbatimin e Objektivit 16 të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara, duke u përqendruar konkretisht në Synimin 16.4, që ka si qëllim të ulë në mënyrë të konsiderueshme qarkullimin e paligjshëm të kapitalit financiar dhe armëve deri në vitin 2030.

Dokumenti gjithashtu përbën një mjet për matjen e progresit dhe një udhëzues drejt një mbështetjeje më të koordinuar dhe sinergjike për rajonin në këtë fushë, duke çuar në përdorimin efektiv dhe efikas të burimeve të donatorëve. Udhërrëfyesi do të operacionalizohet nëpërmjet planeve të veprimit të përshtatura, të cilat do të integrohen dhe do të mbështesin strategjitë dhe planet kombëtare të veprimit egzistuese për AVL me objektiva të matshme dhe tregues konkretë kundrejt së cilëve do të matet progresi në nivel kombëtar dhe rajonal.

Udhërrëfyesi është përgatitur në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha institucionet përkatëse të rajonit, nën kujdesin e Republikës Federale të Gjermanisë dhe me mbështetjen teknike të SEESAC[5] dhe është koordinuar me Mbretërinë e Bashkuar, Francën dhe Komisionin Evropian. Udhërrëfyesi është përgatitur bazuar në Deklaratën e Përbashkët të zëvendësministrave të brendshëm dhe zëvendësministrave të punëve të jashtme në Evropën Jug-

---

[3] Procesi i Berlinit është një nismë që synon rritjen e bashkëpunimit rajonal në Ballkanin Perëndimor dhe nxitjen e integrimit të rajonit në Bashkimin Evropian. Ai është lançuar më 28 gusht 2014 nga Kancelarja Gjermane Angela Merkel dhe Shtetet Anetare te angazhuara ne proces perfshijne: Austri, Kroaci, France, Gjermani, Itali, Slloveni dhe Mbreteria e Bashkuar.

[4] Komisioni Europian ka marre mandatin ne Mbledhjen e Komitetit te Perbashket ndermjet Eksperteve te Armeve te Zjarrit te Bashkimit Europian dhe Eksperteve te Evropes Juglindore te dates 26 Janar 2018 per te kryer nje vleresim te Planit te Veprimit per trafikimin e paligjshem te armeve te zjarrit, ndermjet BE dhe SEE ne 2015-2019 si dhe te pergatise nje raport per Planin e Veprimit qe do te adoptohet ne 2019. Ne kete kontekst, Udherrefyesi mund te kontribuoje ne vleresimin e Planit te Veprimit (2015-2019). Ne kete kuader, objektivat dhe afatet e permendura reflektojne nje angazhim te partnereve te Ballkanit Perendimor dhe nuk paragjykojne permbajtjen e Planit te ri te Veprimit.

[5] SEESAC koordinon veprimtarite në lidhje me kontrollin e armëve dhe luftën kundër trafikimit të paligjshëm të armëve të zjarrit, bazuar në "Planin rajonal të zbatimit në luftën kundër përhapjes së armëve të vogla dhe të lehta në Evropën Juglindore" sic dhe referohet ne Deklaratën e Përbashkët për rritjen e luftës kundër trafikimit të paligjshëm të armëve të zjarrit dhe municioneve të tyre në Ballkanin Perëndimor, miratuar nga Forumi Ministerial BE-Ballkani Perëndimor për Drejtësinë dhe Punët e Brendshme më 16 dhjetor 2016, duke kontribuar gjithashtu në bashkerendimin e përpjekjeve dhe sinergjive të mekanizmit të Qeverisjes Integruese të Sigurisë së Brendshme (IISG), i krijuar së fundmi, perkatesisht Iniciativa kunder krimit te organizuar, Iniciativa e Sigurise se Kufijve, dhe Iniciativa kunder terrorizmit.

lindore dhe elementët e Udhërrëfyesit, të miratuar në takimin e Podgoricës. Gjithashtu, janë organizuar takime konsultative me komisionet e armëve të vogla dhe të lehta në të gjithë rajonin, për të garantuar angazhimin rajonal dhe qëndrueshmërinë e rezultateve. Në përpjekje për të garantuar një qasje gjithëpërfshirëse, janë bërë konsultime me komunitetet lokale, përfaqësues të shoqërisë civile dhe me partnerë rajonalë dhe ndërkombëtarë.

Që zbatimi i Udhërrëfyesit të jetë i suksesshëm kërkohen përpjekje të bashkërenduara të autoriteteve të Ballkanit Perëndimor, si dhe mbështetja e përqendruar dhe e koordinuar dhe në kohën e duhur e partnerëve ndërkombëtarë dhe donatorëve.

Më 28-29 Maj 2018 autoritetet e Ballkanit Perëndimor u takuan në Tiranë, në Takimin e 9-të Rajonal të Komisioneve të AVL-ve, dhe konsoliduan draftin përfundimtar dhe ia paraqitën atë Ministrisë së Jashtme Federale të Gjermanisë për ta përfshirë në axhendën e Procesit të Berlinit.

Ky dokument u miratua në Samitin BE-Ballkani Perëndimor, në Londër, më 10 korrik 2018.

VIZIONI I UDHËRRËFYESIT:

Ballkani Perëndimor është një rajon më i sigurtë dhe një eksportues sigurie, me mekanizma gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm, të harmonizuar plotësisht me standardet e Bashkimit Evropian dhe standartet e tjera ndërkombëtare, për të **identifikuar, parandaluar, dënuar dhe kontrolluar** keqpërdorimin, trafikimin dhe zotërimin e paligjshëm të armëve të zjarrit, municioneve dhe eksplozivëve.

Takimi i Nivelit të Lartë në Podgoricë, shkurt 2018

OBJEKTIVI 1.	Brenda vitit 2023, të garantohet miratimi i legjislacionit për kontrollin e armëve, plotësisht i harmonizuar me kuadrin rregullator të BE-së dhe detyrimet e tjera ndërkombëtare përkatëse dhe i standardizuar me të gjithë rajonin.
OBJEKTIVI 2.	Brenda vitit 2024, të garantohet se politikat dhe praktikat për kontrollin e armëve në Ballkanin Perëndimor janë bazuar në statistika dhe udhëhiqen nga informacionet e inteligjencës.
OBJEKTIVI 3.	Brenda vitit 2024, të ulet në mënyrë të konsiderueshme qarkullimi i paligjshëm i armëve të zjarrit, municioneve dhe eksplozivëve (AME) drejt, brenda dhe përtej Ballkanit Perëndimor.
OBJEKTIVI 4.	Brenda vitit 2024, të ulet në mënyrë të konsiderueshme oferta, kërkesa dhe keqpërdorimi i armëve të zjarrit nëpërmjet ndërgjegjësimit, edukimit, informimit dhe promovimit të kontrollit.
OBJEKTIVI 5.	Brenda vitit 2024, të ulet mjaftueshëm numri i përllogaritur i armëve të zjarrit që zotërohen në mënyrë të paligjshme në Ballkanin Perëndimor.
OBJEKTIVI 6.	Ne menyre sistematike, të ulet sasia e tepërt dhe të shkatërrohen armët e vogla dhe të lehta dhe municioneve te tyre të kapura.
OBJEKTIVI 7.	Të ulet në mënyrë të konsiderueshme rreziku i përhapjes dhe devijimit të armëve të zjarrit, municioneve dhe eksplozivëve.

Udhërrëfyesi i jep rëndësi të veçantë rritjes së barazisë gjinore. Në këtë kontekst, ky dokument është bazuar në një analizë gjinore për kontrollin e AVL-ve/armeve te zjarrit në rajon[6]; dhe përforcon rekomandimet e tij kyçe[7]. Përveç kësaj, në përgatitjen e Udhërrëfyesit kanë kontribuar në mënyrë të barabartë burra dhe gra. Integrimi i perspektivës gjinore dhe zbatimi i tij nëpërmjet Planeve Kombëtare të Veprimit do të monitorohet dhe vlerësohet me kujdes, si një element kyç për arritjen e një rezultati më të mirë, më të qëndrueshëm dhe efikas.

[6] Çështjet gjinore dhe AVL-të në Evropën Juglindore, SEESAC (2016), shih: http://www.seesac.org/f/docs/Armed-Violence/Gender_and_SALW_Albanian-online.pdf.

[7] Një instrument praktik për integrimin e perspektivës gjinore në kuadrin legjislativ dhe të politikave për AVL-të, SEESAC (2016), shih: http://www.seesac.org/f/docs/Gender-and-Security/Gender_and_SALW_Toolkit_alb.pdf.

TREGUESIT KRYESORË TË PERFORMANCËS

Zbatimi i Udhërrëfyesit do të monitorohet dhe vlerësohet rregullisht sipas treguesve kryesorë të performancës (KPI) si më poshtë:

1. Numri i dokumentave ligjore për kontrollin e armëve në Ballkanin Perëndimor plotësisht te harmonizuar me legjislacionin e BE-së, Traktatin për Tregtinë e Armëve dhe Protokollin e OKB-së *kundër Prodhimit të Paligjshëm dhe Trafikimit të Armëve të Zjarrit, Pjesëve të tyre, Komponentëve dhe Municioneve (Protokolli* për Armët e Zjarrit);
2. Numri i dokumentave të politikave për kontrollin e armëve të bazuara në fakte, të hartuar në secilin prej juridiksioneve të Ballkanit Perëndimor, të cilat trajtojnë gjithashtu nevojat e burrave, të grave, djemve dhe vajzave;
3. Numri i rasteve, individëve dhe sasia e armëve të zjarrit, municioneve dhe eksplozivëve (AME) të keqpërdorura dhe të trafikuara të çuara për ndjekje penale dhe të gjykuara krahasuar me numrin e raporteve të institucioneve ligjzbatuese për konfiskimet;
4. Numri i rasteve dhe sasia e AME të kapura në territorin e brendshëm krahasuar me numrin e rasteve dhe sasinë e AME të kapura në kufi;
5. Numri i rasteve të raportuara të AME të kapura në kufijtë e Bashkimit Evropian dhe me prejardhje nga Ballkani Perëndimor, krahasuar me numrin e AME të kapura në të gjithë Bashkimin Evropian dhe me prejardhje ose të devijuara nga Ballkani Perëndimor.
6. Numri i AME-ve për të cilat licencat e eksportit janë lëshuar nga Ballkani Perëndimor, të identifikuara si të devijuara nëpërmjet procedurës së kontrollit pas transportit;
7. Njësitë Qendrore për armët e zjarrit që janë ngritur dhe që janë funksionale në secilin prej juridiksioneve të Ballkanit Perëndimor;
8. Numri i rasteve të bashkëpunimit ndërinstitucional në nivel operacional, duke përfshirë hetimin, ndjekjen penale dhe fazat paraprake të procedurave gjyqësore;
9. Numri i rasteve të bashkëpunimit operacional që rezultojne nga informacioni i inteligjencës, duke përfshirë inteligjencën balistike në luftën kundër krimeve që lidhen me armët e zjarrit me autoritetet në rajon, shtetet anëtare dhe agjencitë e BE-së si edhe agjencitë ndërkombëtare të zbatimit të ligjit.
10. Numri i incidenteve me armë zjarri dhe viktimave të prekura nga keqpërdorimi i armëve të zjarrit, i ndarë sipas gjinisë dhe moshës, në secilin prej juridiksioneve të Ballkanit Perëndimor;
11. Numri i AME-ve të dorëzuara vullnetarisht, si edhe i armëve të zjarrit të legalizuara ose të çaktivizuara;
12. Numri i AVL/armëve te zjarrit, municioneve dhe eksplozivëve të raportuar si të konfiskuar ose tepricë që shkatërrohet sistematikisht;
13. Numri i depove për magazinimin e AVL/armëve te zjarrit dhe municioneve të tyre që përmbushin standardet ndërkombëtare për sigurinë;
14. Përqindja e qytetarëve të kënaqur (të ndarë sipas moshës dhe gjinisë) ose që ndihen të sigurtë nga dhuna me armë në të gjithë Ballkanin Perëndimor.

1. KUADRI LEGJISLATIV DHE RREGULLATOR PËR AVL-TË /ARMËT E ZJARRIT DHE STANDARDIZIMI I TIJ

Kontrolli i qëndrueshëm i AVL-ve/armëve te zjarrit kërkon politika, procedura dhe praktika menaxhimi që zbatohen në nivel global, rajonal, kombëtar dhe lokal. Ky kontroll përfshin aktorë ndërkombëtarë, kombëtarë, tregtarë, të sigurisë, joqeveritarë dhe të tjerë që operojnë sipas kushteve të përcaktuara me kujdes dhe të ndërvarura. Ndaj, kërkohet një kuadër i fortë legjislativ në pajtim me standardet dhe udhëzimet ndërkombëtare.

Ekziston një nevojë e qartë dhe urgjente për një kuadër të tillë legjislativ dhe rregullator për kontrollin e AVL-ve/armëve te zjarrit në Ballkanin Perëndimor që të rregullojë siç duhet kontrollin e armëve, të lehtësojë reagimin ndaj kërcënimeve përkatëse dhe që të jetë plotësisht i harmonizuar me kuadrin e Bashkimit Evropian. Në zbatim të këtij objektivi, arritja e synimeve të përgjithshme të përcaktuara do të garantojë harmonizimin e plotë me marrëveshjet/standardet e BE-së dhe marrëveshjet/standardet e tjera ndërkombëtare, që, si rrjedhojë, do të mundësojnë përputhshmërinë e ligjeve dhe procedurave për kontrollin e armëve në të gjithë Ballkanin Perëndimor dhe standardizimin e procedurave dhe praktikave për kontrollin e AVL-ve/armëve te zjarrit, gjë që do të lejonte një reagim më të mirë dhe më efikas ndaj kërcënimeve që vijnë nga armët e zjarrit në nivel kombëtar dhe rajonal.

Masat e parashikuara do të mbështeten në standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare në fushën e kontrollit të AVL-ve/armëve te zjarrit, që do të garantojnë koordinimin e parandalimit, zbutje, përgjigje, konsistencë, përputhshmëri maksimale, ndërveprim dhe cilësi.

OBJEKTIVI	SYNIMET E PËRGJITHSHME	REFERENCA AKTUALE	AFATI KOHOR
OBJEKTIVI 1. *Brenda vitit 2023, të garantohet miratimi i legjislacionit për kontrollin e armëve, plotësisht i harmonizuar me kuadrin rregullator të BE-së dhe detyrimet e tjera ndërkombëtare përkatëse dhe i standardizuar me të gjithë rajonin*	Të vendoset një kuadër ligjor i plotë për të luftuar të gjitha format e keqpërdorimit, trafikimit dhe zotërimit të paligjshëm të armëve të zjarrit, municioneve dhe eksplozivëve (AME)	Të gjitha vendet kanë ligj për armët, por nuk ka akte nënligjore për çaktivizimin ose markimin; kërkohet një shqyrtim më i imtësishëm dhe miratimi në kohë i legjislacionit dytësor për të garantuar se ai mbështet legjislacionin parësor; Ka strategji kombëtare dhe plane kombetare për AVL-të të paktën në 5 vende	2020

OBJEKTIVI	SYNIMET E PËRGJITHSHME	REFERENCA AKTUALE	AFATI KOHOR
OBJEKTIVI 1. *Brenda vitit 2023, të garantohet miratimi i legjislacionit për kontrollin e armëve, plotësisht i harmonizuar me kuadrin rregullator të BE-së dhe detyrimet e tjera ndërkombëtare përkatëse dhe i standardizuar me të gjithë rajonin*	Të garantohet se është ngritur kuadri ligjor dhe rregullator për prodhuesit e AME	Nivel i ulët ndërgjegjësimi për mundësinë e devijimit të pjesëve dhe komponentëve për shkak të hallkave të munguara në procesin e kontrollit të prodhimit; rregullore dhe kërkesa minimale për sigurinë dhe mbikqyrjen për prodhuesit e eksplozivëve dhe subjektet ligjore që përdorin eksplozivë; asnjë rregullore për prekursorët	2020
	Legjislacioni për kontrollin e armëve të harmonizohet plotësisht me kuadrin ligjor të BE-së dhe në përputhje me marrëveshjet/ standardet ndërkombëtare	Direktiva e BE-së për Armët e Zjarrit; Rregullorja e BE-së për Çaktivizimin; Akti Zbatues i BE-së për armët e alarmit dhe sinjalizimit, Qëndrimi i Përbashkët e BE-së për Eksportin e Armëve; Rregullorja e BE-së për Markimin, Udhëzuesi i BE-së për ngritjen dhe funksionimin e ekipeve të përbashkëta të hetimit; Rregullorja 258/2012 Harmonizimi me Protokollin e OKB-së për Armët e Zjarrit, Udhëzimet e OSBE-së, ATT (Traktati i Tregtise se Armëve) dhe ITI (Instrumenti ndërkombëtar i gjurmimit), ISAC (Standardet ndërkombëtare për kontrollin e armëve të vogla)	2019 - 2023
	Të garantohet përputhshmëria e kuadrove ligjore për kontrollin e armëve në të gjithë Ballkanin Perëndimor, e cila garanton bashkëpunimin operacional të drejtpërdrejtë.	Ligji për armët (në veçanti, për klasifikimin e armëve) ka mospërputhje të konsiderueshme; Kodet e Procedurës Civile të ngjashme; Kodet Penale të ngjashme; ligjet për të dhënat personale janë miratuar, por vazhdojnë të kenë mospërputhje	2019 - 2023
	Të garantohet standardizimi i procedurave dhe praktikave në fushën e kontrollit të armëve dhe hetimeve për AME-të	Nuk është miratuar një paketë të dhënash për shkëmbimin e informacionit të inteligjencës; nuk ka shkëmbim sistematik informacioni; hetime paralele sporadike; përpjekje sporadike për të përmbushur standardin ENFSI për hetimet e mjekësisë ligjore; vetëm një përfitues pregatit raportin për analizën e krimeve me armë zjarri; Procedurat për kontrollin e AVL-ve/armëve te zjarrit nuk janë përgatitur plotësisht në përputhje me standardet e përcaktuara të BE-së dhe me praktikat më të mira ekzistuese; mbikëqyrja vjetore cilësore dhe sasiore për zbatimin e procedurave dhe praktikave mungon; vetëm një laborator i mjekësisë ligjore në rajon ka arritur të akreditohet sipas standardit ISO 17025 për hetimet balistike dhe procese të tjera përkatëse	2019 - 2023
	Të shkëmbehen praktikat e mira me fokus konkret në fushat e përcaktuara në Udhërrëfyes	Të garantohet shkëmbimi i praktikave të mira për hetuesit e policisë, prokurorët, hetuesit e mjekësisë ligjore dhe oficerët doganorë nëpërmjet SEEFEN (Rrjeti i Ekspertëve të Armëve të Zjarrit në Evropën Juglindore), kontrolli i eksporteve nëpërmjet procesit te shkembimit te informacionit, zhvillimit te politikave nepermjet Komisioneve rajonale për AVL-të	2023

2. POLITIKAT E BAZUARA NË STATISTIKA DHE VLERËSIMET E RREZIKUT

Po bëhet gjithnjë e më e dukshme nevoja për politika që i përgjigjen një realiteti në ndryshim, për të trajtuar sfida të reja dhe të vjetra në kontrollin e armëve, siç janë për shembull teknologjitë e reja me mënyra e funksionimi gjithnjë në ndryshim si edhe mjediset dinamike sociale, politike dhe të sigurisë. Këto politika duhet të bazohen në një kuadër të shëndoshë dhe gjithëpërfshirës për të zbatuar me efiçencë dhe efektivitet masat e kërkuara të kontrollit. Për t'iu përgjigjur kërcënimeve ekzistuese dhe të reja, duhet të aftësohen aktorët rajonalë që të shfrytëzojnë plotësisht burimet ekzistuese, të identifikojnë mangësitë dhe të përcaktojnë sinkroninë potenciale që do të mundësonte një rregullim, menaxhim dhe zbatim më të mirë të detyrave nga të gjithë aktorët e ndryshëm të përfshirë.

Nevoja për një paketë informacioni të saktë dhe të përditësuar për të gjitha aspektet që mbulojnë kontrollin e armëve tashmë është përcaktuar si prioritet nga disa qeveri në rajon. Një Sondazh Rajonal për AVL-të që po zbatohet në 2018 zbuloi se praktikat e institucioneve për grumbullimin e të dhënave janë jokonsistente, të pastandardizuara dhe shpesh mungon niveli i nevojshëm i hollësive, veçanërisht kur bëhet fjalë për ndarjen e të dhënave sipas moshës dhe gjinisë. Shpesh nuk ka koordinim ndërmjet institucioneve, gjë e cila bëhet pengesë për zhvillimin e një perspektive sektoriale dhe politikave të përshtatshme të bazuara në statistika. Arritja e synimeve të përgjithshme të përfshira në këtë objektiv do të garantojë politika të bazuara në statistika, që shërbejnë si një bazë e shëndoshë për një përgjigje efektive dhe efikase ndaj kërcënimeve të AVL-ve/armëve te zjarrit.

Për më tepër, grumbullimi më i mirë i të dhënave, ndarja dhe analiza e tyre do të bëjë të mundur që vlerësimet e duhura analitike të përkthehen në njohuri për menaxhimin e rreziqeve në luftën kundër trafikimit të paligjshëm dhe keqpërdorimit të armëve të zjarrit duke kontribuar kështu në një qasje politikash të bazuara në informacionet e inteligjencës. Në përpjekje për të garantuar një politikëbërje që plotëson kërkesat gjinore, do të bëhet kujdes që të garantohet, në të gjithë rajonin, mundësimi i ndarjes së të dhënave të grumbulluara sipas gjinisë dhe moshes.

Shkëmbimi i informacioneve operacionale dhe strategjike të inteligjencës do të çojë më tej në parandalimin dhe zbutjen sistematike të kërcënimeve që lidhen me armët e zjarrit në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar. Mbledhja dhe analizimi i informacionit si dhe shqyrtimi sistematik i informacionit për të identifikuar kërcënimet e mundshme, rreziqet, problemet dhe mundësitë që krijohen do të mundësojë gatishmëri më të madhe, si dhe marrjen e masave zbutëse dhe shfrytëzimin e mundësive në procesin e politikëbërjes, duke e bërë qasjen të qëndrueshme.

Në përfundim, statistikat e detajuara që do të grumbullohen do të ndikojnë në raportimin kombëtar që të gjitha institucionet e rajonit do të duhet të bëjnë për të treguar kontributin e tyre në procesin e anëtarësimit në BE (progres raportet, raporti i gjurmimit, etj.), në marrëveshjet ndërkombëtare (OKB, OSBE dhe instrumente të tjera), dhe në veçanti për zbatimin e Objektivit të Zhvillimit të Qëndrueshëm 16.

OBJEKTIVI	SYNIMET E PËRGJITHSHME	REFERENCA BAZË	AFATI KOHOR
OBJEKTIVI 2. *Brenda vitit 2024, të garantohet se politikat dhe praktikat për kontrollin e armëve në Ballkanin Perëndimor janë bazuar në statistika dhe udhëhiqen nga informacionet e inteligjencës*	Standardizimi dhe institucionalizimi i grumbullimit të të dhënave për armët e zjarrit sipas gjinisë dhe moshës, në lidhje me ndalimet e AVL-ve/armëve te zjarrit të ligjshme dhe të paligjshme, incidentet e dhunshme me armë, provat balistike dhe të dhëna të tjera që lidhen me armët e zjarrit që çojnë në analizën rajonale periodike të rrezikut për AME dhe vlerësimin e kërcënimit	Praktikat për grumbullimin e të dhënave nuk janë të zhvilluara sa duhet, janë të pastandardizuara dhe jokoherente dhe përdoren në mënyrë sporadike për të ndikuar në zhvillimin e politikave; të dhënat bazë për AVL-të/armët e zjarrit shpesh janë të padisponueshme dhe shpesh nuk ka koordinim mes institucioneve, gjëra të cilat pengojnë përgatitjen e politikave të bazuara në statistika	2019 - 2024
	Forcimi i funksioneve të ndarjes së detyrave, koordinimit dhe monitorimit të Komisioneve te AVL-ve për të garantuar politika efektive për parandalimin, zbutjen, reagimin dhe eliminimin e keqpërdorimit, trafikimit dhe përhapjes së paligjshme të armëve të zjarrit	Komisionet e AVL-ve janë ngritur në të gjitha vendet përfituese, shumica me mandat të dobët për përgatitjen e politikave; proceset për zhvillimin e politikave për AVL-të/armët e zjarrit që përfshijnë aktorët përkatës të qeverisë dhe organizatat e shoqerise civile nuk janë të harmonizuara; mekanizmat e caktimit të detyrave koordinimit në nivel institucional dhe ndërinstitucional nuk janë qartësisht të përcaktuar	2020
	Rritja e kapaciteteve kombëtare analitike dhe institucionalizimi i analizës së të dhënave për armët e zjarrit	Kapacitete të kufizuara të aktorëve të politikave të AVL-ve/armëve te zjarrit dhe oficerëve të zbatimit për të kryer analiza që do të garantonin politika/zbatim të bazuar në informacion; aktualisht nuk është kryer asnjë analizë e ndikimit e bazuar në statistika	2020
	Garantimi i shkëmbimit të informacionit operacional dhe strategjik, i të dhënave, i informacionit të inteligjencës si dhe i provave me Europol, Frontex dhe Eurojust	Një FFP (Njësi Qëndrore e Armëve të Zjarrit) është ngritur në një vend përfitues dhe ka nisur procesi për 5 përfitues të tjerë; Mekanizma jo të qartë për caktimin e detyrave dhe koordinimin për sa i përket rasteve të krimeve të kryera me armë zjarri; Përdorim i kufizuar i SIENA-s në shkëmbimin e informacionit me Europol dhe në nivel dypalësh; Mungesa e një procedure të miratuar për shkëmbimin e informacionit balistik; Nevojitet thellim i mëtejshëm i bashkëpunimit me Frontex. EMPACT po punon për rritjen e qëndrueshme të shkëmbimit të informacionit ndërmjet shteteve anëtare të BE-së dhe Ballkanit Perëndimor për zbatuesit e ligjit dhe si rrjedhoje për operacionet e bazuara në informacionet e inteligjencës	2020

OBJEKTIVI	SYNIMET E PËRGJITHSHME	REFERENCA BAZË	AFATI KOHOR
OBJEKTIVI 2. *Brenda vitit 2024, të garantohet se politikat dhe praktikat për kontrollin e armëve në Ballkanin Perëndimor janë bazuar në statistika dhe udhëhiqen nga informacionet e inteligjencës*	Institucionalizimi i grumbullimit sistematik të të dhënave për drejtësinë penale në të gjithë Sektorin e Drejtësisë Penale (në nivel policie, dogane, shërbimi prokurorie, shërbimi gjykate, të shërbimeve korrigjuese dhe të vuajtjes së dënimit)	Ekzistojnë metodologji të ndryshme për grumbullimin e të dhënave; nuk ka mundësi për të pasur një përmbledhje krahasuese të të dhënave statistikore dhe të informacioneve të tjera nga të gjitha institucionet në Sektorin e Drejtësisë Penale; raportet vjetore nga të gjitha institucionet për përpunimin e të dhënave për kriminalitetin që lidhet me armët e zjarrit nuk janë të krahasueshëm	2024
	Ngarkimi i të gjithë përfituesve në Ballkanin Perëndimor me detyrimin për të dhënë përgjigje, gjë që do të mundësonte përmirësimin e hetimeve proaktive në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar	Numër joproporcional i konfiskimeve të policisë kundrejt numrit të rasteve të ndjekura ligjërisht dhe të gjykuara; Përgjigjja e detyrueshme ndaj kërkesave për informacion dhe veprimet janë sporadike dhe jo uniforme; përgjigjet ndaj kërkesave për informacion dhe shkresave zyrtare ndryshojnë në kohë dhe cilësinë e përgjigjes; po ashtu, nuk bëhet ndjekja dhe nuk merret asnjë herë përgjigje për informacionet e shkëmbyera me partnerët ndërkombëtarë; Kontributet dhe reagimet e përfituesve për Ditët e Përbashkëta të Veprimit (DPV) ndryshojnë në cilësi dhe sasi; asnjë koordinator i DPV i caktuar	2024
	Të gjitha shërbimet policore të Ballkanit Perëndimor janë të lidhura dhe hedhin rregullisht të dhënat e tyre për armët e zjarrit të humbura dhe të vjedhura në Sistemin për Menaxhimin e Regjistrimit dhe Gjurmimit të Armëve të Paligjshme (iARMS) të INTERPOL	Pothuajse të gjitha shërbimet policore të Ballkanit Perëndimor janë të lidhura me Sistemin për Menaxhimin e Regjistrimit dhe Gjurmimit të Armëve të Paligjshme (iARMS) të INTERPOL	2024
	Të garantohet se çdo AME e mbledhur ose konfiskuar gjurmohet menjëherë në mënyrë automatike (në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar)	Gjurmimi i AME-ve është sporadik dhe jo i bazuar në informacione; Analiza e markimit është sporadike dhe informacioni as nuk standardizohet e as nuk shkëmbehet	2022
	Integrim i plotë i çështjeve për gjininë dhe moshën në politikat për kontrollin e AVL-ve/armëve te zjarrit dhe garantimi i pjesëmarrjes reale të grave në kontrollin e AVL-ve /armëve te zjarrit	Integrimi i kufizuar i perspektivës gjinore dhe moshore ka ndikuar negativisht në efektivitetin e masave për kontrollin e AVL-ve. Përfaqësim i pamjaftueshëm i grave, gjë e cila pengon artikulimin e perspektivës gjinore në politikat e AVL-së/armëve te zjarrit	2022

3. KONTROLLI NDËRKUFITAR DHE I EKSPORTIT TË ARMËVE

Qasja gjithëpërfshirëse ndaj luftës së tregtisë dhe qarkullimit të paligjshëm të armëve të zjarrit, komponentëve kryesorë, municioneve dhe eksplozivëve në këtë rajon përforcohet nga disa faktorë, nga të cilët një nga kërkesat kryesore është përforcimi i kontrollit ndërkufitar. Kontrolli kufitar efektiv shërben jo vetëm si faktor parandalues për krimin në të gjitha format e tij, por edhe si një masë që rrit besimin. Kontrolli kufitar efektiv dhe i rreptë është themeli i çdo programi afatgjatë për sigurinë kombëtare dhe rajonale.

Mbi 95% e të gjitha armëve prodhohen në mënyrë të ligjshme, por shumë prej tyre devijojnë më pas drejt përdorimit të paligjshëm dhe kjo është një sfidë kyçe e cila kërkon kontroll, monitorim dhe parandalim të përforcuar nëpërmjet mekanizmave, kapaciteteve dhe procedurave të përmirësuara të kontrollit dhe masave për transparencë.

Përpjekjet e përgjithshme për reforma në sektorin e sigurisë, që vazhdojnë në secilin prej përfituesve, kanë bërë përparime të konsiderueshme në kapacitetet e kontrollit kufitar. Ndërkohë që përpjekjet e ndërmarra deri më sot po menaxhojnë tranzicionin e përgjithshëm drejt një zbatimi më efektiv, më të përgjegjshëm dhe më efikas të ligjit, egziston nevoja për të ofruar asistencë të përqendruar që do të rriste profesionalizimin e aktorëve në rajon në mënyrë që të përmirësojnë kapacitetet e tyre për të parandaluar dhe luftuar trafikimin e armëve të zjarrit, komponentëve kryesorë të tyre, municioneve dhe eksplozivëve. Nivelet ekzistuese të bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve ndërkufitare do të përfitojnë një asistencë të mëtejshme të përqendruar dhe të përshtatur sipas nevojave.

Udhërrëfyesi do të udhëzojë institucionet në rajon që të përparojnë më tej në zbatimin e kuadrove të tyre ligjorë dhe të përdorin burimet teknologjike, njerëzore dhe të tjera për një kontroll ndërkufitar, ndërsektorial të përmirësuar dhe të përforcuar për të luftuar trafikimin e armëve të zjarrit , komponentëve kryesorë dhe municioneve të tyre dhe eksplozivëve. Ky dokument do të punojë në mbështetje të plotë të Ciklit të Politikave të BE-së kundër krimeve të rënda dhe krimit të organizuar, konkretisht *Plani Operacional i Veprimit 2018 EMPACT - ARMËT E ZJARRIT.*

OBJEKTIVI	SYNIMET E PËRGJITHSHME	REFERENCA BAZË	AFATI KOHOR
OBJEKTIVI 3. *Brenda vitit 2024, të ulet në mënyrë të konsiderueshme qarkullimi i paligjshëm i armëve të zjarrit, municioneve dhe eksplozivëve (AME) drejt, brenda dhe përtej Ballkanit Perëndimor*	Të garantohet zbatimi i plotë dhe monitorimi i kuadrit ligjor, politik dhe procedural për trafikimin e AME-ve	Bashkëpunim i kufizuar sipas strategjive ekzistuese për MIK-në (Menaxhimi i Integruar i Kufijve); mungesa e procedurave dhe kapaciteteve për zbulimin, analizën, identifikimin dhe hetimin e AME-ve; procedurat për analizën e rrezikut për policinë kufitare (CIRAM) egzistojnë, por nuk janë të përqendruara tek armët e zjarrit; nuk është ngritur një sistem për grumbullimin dhe shkëmbimin e të dhënave në përputhje me Studimin Global për Trafikimin e Armëve të Zjarrit të UNODC; Metodologjia SOCTA është miratuar në të gjithë rajonin; Numër i vogël i ndjekjeve penale / padive / dënimeve për keqpërdorim dhe trafikim të AME; Gjyqësori është më i prirur për të klasifikuar veprat si zotërim të paligjshëm dhe jo trafikim; Numër i vogël i rasteve dhe dënimi nën minimumin ligjor i dekurajojnë ekspertët dhe institucionet	2024
	Të parandalohet trafikimi (kontrabanda, tregtia dhe tranziti i paligjshëm) i AME-ve nëpërmjet proceseve dhe pajisjeve të përmirësuara dhe trajnimit të njësive të synuara ligjzbatuese	Kapacitete të dobëta zbulimi, analize, identifikimi dhe hetimi; nivel i larte ndërrimi/largimi i personelit te specializuar; Sasi dhe cilësi e pamjaftueshme e pajisjeve për zbulimin e AME-ve - shumica të vjetruara; në procedurat e brendshme të pajtueshmërisë janë zbuluar raste devijimi; Rekorde të ulëta të numrit të rasteve te ndjekura penalisht dhe të rasteve të gjykuara të keqpërdorimit dhe trafikimit të AME; mungon trajnimi profesional / specializim fillestar dhe sistematik	2024
	Të forcohet thelbësisht kontrolli, monitorimi dhe parandalimi i devijimit të tregtisë së ligjshme nëpërmjet përmirësimit të kapaciteteve, procedurave dhe transparencës	Janë vendosur mekanizma kontrolli për armët konvencionale, por jo për prekursorët; janë ngritur mekanizmat kombëtarë, rajonalë dhe ndërkombëtar të monitorimit; janë raportuar raste të devijimit; Procesi Rajonal për shkëmbimin e Informacionit; Baza e të dhënave e brokerave (ndërmjetësuesve) nuk përditësohet rregullisht	2019 - 2024
	Forcimi i mekanizmave ekzistuese dypalëshe, rajonale dhe ndërkombëtare dhe nxitja e formave të reja të praktikave të mira për të luftuar trafikimin e armëve të zjarrit	Egzistenca e disa platformave rajonale që lehtësojnë shkëmbimin e praktikave të mira të aktorëve të Ballkanit Perëndimor në nivele të ndryshme; Procesi i Komisioneve të AVL-ve, RASR, EMPACT, SEEFEN, SEEFEG, RACVIAC, RIEP; EU P2P Janë ngritur vetëm disa posta kufitare dhe patrulla të përbashkëta; 2 Ditë të Përbashkëta Veprimi dhe 2 operacione të drejtuara nga Interpol; Shfrytëzim i ulët i asistencës ndërkombëtare dhe instrumentave të veçanta të hetimit të ofruara nga EMPACT dhe EUROPOL. Kurset e trajnimi të TAIEX dhe CEPOL – përfshirë programet e shkëmbimit të CEPOL për zyrtarët janë përdorur në mënyrë sporadike; kurset kombëtare të trajnimit organizohen shumë rrallë	2024

4. NDËRGJEGJËSIMI, EDUKIMI, PROMOVIMI I KONTROLLIT DHE INFORMIMI

Sipas vlerësimeve, ka ende një numër të madh armësh që mbahen në mënyrë të paligjshme nga qytetarët në Ballkanin Perëndimor dhe prania e tyre është më e dukshme në incidentet e gjuajtjes me armë gjatë festave, që në shumë vende ende pranohet dhe tolerohet gjerësisht nga shoqëria. Statistikat e mbledhura gjatë vitit të fundit tregojnë se kërcënimet për jetën dhe ato fizike kanë rënë, por ende regjistrohen mjaft raste të vetëvrasjes me armë dhe keqpërdorimit të armëve në rastet e dhunës me bazë gjinore. Analiza e ndikimit të armëve të zjarrit kryhet vetëm në mënyrë sporadike dhe ajo tregon një mungesë të një qasjeje dhe angazhimi gjithëpërfshirës në planifikimin dhe zbatimin e masave dhe veprimeve gjithëpërfshirëse të ndërgjegjësimit, që shpesh janë me përkatësi kombëtare të kufizuar.

Në zbatim të këtij Objektivi, Udhërrëfyesi përcakton synime të projektuara për të trajtuar tensionet shoqërore, çështjet e besimit dhe një sërë sfidash që lidhen me njohuritë, qëndrimin dhe sjelljen ku përfshihen institucionet shtetërore, subjektet private, komunitetet dhe individët. Vëmendje do t'i kushtohet trajtimit të keqpërdorimit të armëve të zjarrit në dhunën ndaj grave, dhunën në familje dhe formave të tjera të dhunës me bazë gjinore.

OBJEKTIVI	SYNIMET E PËRGJITHSHME	REFERENCA BAZË	AFATI KOHOR
OBJEKTIVI 4. *Brenda vitit 2024, të ulet në mënyrë të konsiderueshme oferta, kërkesa dhe keqpërdorimi i armëve të zjarrit nëpërmjet ndërgjegjësimit, edukimit, informimit dhe promovimit të kontrollit*	Ndërgjegjësimi i subjekteve të licencuara private dhe juridike për rrezikun e keqpërdorimit dhe përhapjes së paligjshme të AME-ve	Niveli i informacionit i papërshtatshëm në poligonet e qitjes dhe gjuetisë, dyqanet e shitjes me pakicë, shoqëritë e sigurisë; niveli i ulët i informacionit në institucione në veçanti për trafikimin nëpërmjet dërgesave të shpejta/postare dhe portaleve në internet; nivele të ulëta informacioni në shoqëritë e transportit dhe shërbimet e dërgesave për rrezikun e trafikimit të paligjshëm	2019 - 2024
	Ndërgjegjësimi i prodhuesve të AME-së për rrezikun e devijimit	Niveli i ulët i ndërgjegjësimit për mundësinë e devijimit të pjesëve dhe komponentëve për shkak të hallkave të munguara në procesin e kontrollit të prodhimit; rregullore minimale, kërkesa minimale për sigurinë dhe një anashkalim për prodhuesit e eksplozivëve dhe subjektet ligjore që përdorin eksplozivë; asnjë rregullore për prekursorët	2019 - 2024
	Zhvillimi i partneriteteve të qëndrueshme për promovimin e kontrollit, përforcuar informimin dhe për të arritur deri tek shumëfishuesit e mesazheve	Partneritetet janë sporadike, të kufizuara në objekt dhe kohëzgjatje dhe nuk janë të qëndrueshme; Partneritet sporadik midis institucioneve shtetërore dhe shoqërisë civile; Numer i ulët i aktakuzave dhe gjykimeve të keqpërdorimit dhe trafikimit të AME së bashku me një politikë të butë dënimi që nuk përbëjnë pengesë për shkelësit potencialë të ligjit dhe që dërgon një mesazh dekurajues për popullatën e përgjithshme	2020

OBJEKTIVI	SYNIMET E PËRGJITHSHME	REFERENCA BAZË	AFATI KOHOR
OBJEKTIVI 4. *Brenda vitit 2024, të ulet në mënyrë të konsiderueshme oferta, kërkesa dhe keqpërdorimi i armëve të zjarrit nëpërmjet ndërgjegjësimit, edukimit, informimit dhe promovimit të kontrollit*	Ndërgjegjësimi i popullsisë së përgjithshme, gra dhe burra, për rrezikun e keqpërdorimit, mbajtjes së paligjshme dhe trafikimit të AME-ve	Shifra të larta të zotërimit të paligjshëm të raportuara; mungesa e metodologjisë së dakordësuar për vlerësimin e numrit të paligjshëm të armëve të zjarrit në të gjithë rajonin; numër i lartë i vetëvrasjeve me armë zjarri dhe keqpërdorimi i armëve të zjarrit në dhunën me bazë gjinore; mungesa e qasjes dhe angazhimit gjithëpërfshirës në planifikimin dhe zbatimin e masave të ndërgjegjësimit, duke perfshire dhe institucionet arsimore; angazhim kombëtar i kufizuar	2020
	Ndërgjegjësimi i të rinjve për rreziqet e keqpërdorimit të AVL-ve/armëve te zjarrit, duke qenë se ata përfaqësojnë shumicën e autorëve dhe viktimave të incidenteve që lidhen me armët e zjarrit	Meshkujt e rinj përfaqësojnë përqindjen më të lartë të autorëve dhe të viktimave të incidenteve me armë zjarri. Ato përfaqësojnë edhe shumicën e atyre që raportohen se mbajnë armë zjarri dhe që ndihen më të sigurtë me armë në shtëpi	2024
	Ndërgjegjësimi për rreziqet e gjuajtjes me armë gjatë festimeve, veçanërisht si kontribuesi kryesor i plagosjeve dhe vdekjeve nga armët e zjarrit	Numër i lartë i plagosjeve dhe vdekjeve si edhe dëmeve të konsiderueshme të shkaktuara nga armët e zjarrit gjatë gjuajtjes me armë për raste festash; Numër i ulët i rasteve të ndjekura / të gjykuara dhe dënime te buta	2022
	Ndërgjegjësimi dhe ulja e keqpërdorimit të armëve të zjarrit në dhunën ndaj grave, dhunën në familje dhe formave të tjera të dhunës me bazë gjinore	Njohuri të pakta për përhapjen e keqpërdorimit të armëve të zjarrit në dhunën në familje dhe me bazë gjinore dhe reagimi institucional i pamjaftueshëm	2020
	Rritja e partneritetit me median dhe ndërgjegjësimi i saj për rëndësinë e raportimit të përshtatshëm për keqpërdorimin e armëve të zjarrit dhe dhunës së shkaktuar nga armët e zjarrit	Disa media raportojnë në mënyrë inkoherente dhe dashamirëse për keqpërdorimin e armëve të zjarrit, kryesisht në kontekstin e "kulturës së armëve", "armët e zjarrit si pjesë e tradites", etj. Reagim i ulët institucional ndaj raportimit dhe ndjekjes së rasteve nga media	2020
	Rritja e besimit në institucionet e sigurisë si ofrues të sigurisë së përshtatshme dhe të barabartë për të gjithë nëpërmjet veprimtarive të informimit në komunitet, shoqëri dhe rajon	Numri i lartë i armëve të zjarrit të shkurtra të regjistruara justifikohet kryesisht me arsyen e vetëmbrojtjes; shifrat e larta të mbajtjes së armëve të zjarrit pa leje në thelb tregojnë një besim të pamjaftueshëm se institucionet mund të ofrojnë mbrojtje; informimi i papërshtatshëm i komunitetit dhe qasjet për politika komunitare nuk janë në gjendje të trajtojnë mungesën e besimit ndërmjet institucioneve dhe komuniteteve lokale	2019 - 2024

5. GRUMBULLIMI DHE LEGALIZIMI I AVL-VE/ARMËVE TE ZJARRIT

Vlerësohet se një numër i lartë armësh ende mbahen në mënyrë të paligjshme nga qytetarët në Ballkanin Perëndimor. Në duart e gabuara, ato kanë potencial destabilizues dhe efektet e tyre negative mund të shumëfishohen. Si të tilla, ato paraqesin një rrezik të vazhduar për komunitetet, shoqëritë dhe institucionet. Grumbullimi i AVL-ve/armëve te zjarrit është një nga masat e kontrollit dhe ndër veprimtaritë më komplekse duke qenë se ai kërkon një bashkëpunim të ngushtë ndërmjet disa institucioneve si edhe të fitohet besimi i komunitetit/shoqërisë së synuar.

Fushatat e grumbullimit tashmë të zbatuara në rajon kanë treguar se në mënyrë që dorëzimi vullnetar dhe/ose legalizimi i armëve të zjarrit të jetë i suksesshëm, duhet të bëhet një planifikim i përshtatshëm dhe ndërinstitucional që të përforcojë besimin tek institucionet e sigurisë.

Në kundërshtim me këtë historik, qëllimi i Udhërrëfyesit është të arrijë disa synime për uljen e konsiderueshme të armëve të zjarrit që mbahen në mënyrë të paligjshme nëpërmjet gjashtë aspekteve kritike të grumbullimit të AVL-ve/armëve te zjarrit, që përfshin: 1) Konfiskimin 2) Legalizimin 3) Dorëzimin vullnetar 4) Çaktivizimin 5) Armë zjarri të gjetura, dhe 6) Armë zjarri të trashëguara. Këto aspekte, kur kombinohen siç duhet, mund të ulin ndikimin social, ekonomik dhe mjedisor të përhapjes dhe zotërimit të pakontrolluar të AVL-ve/armëve te zjarrit në një juridiksion të caktuar dhe në një rajon si të tërë.

OBJEKTIVI	SYNIMET E PËRGJITHSHME	REFERENCA BAZË	AFATI KOHOR
OBJEKTIVI 5. *Brenda vitit 2024, të ulet mjaftueshëm numri i përllogaritur i armëve të zjarrit që mbahen në mënyrë të paligjshme në Ballkanin Perëndimor*	Rritja e konsiderueshme e numrit të armëve të zjarrit, municioneve dhe eksplozivëve të konfiskuar	Kapacitete dhe pajisje të papërshtatshme zbulimi; numri i armëve të zjarrit të raportuara si të konfiskuara në të gjithë rajonin; përdorimi sporadik i informatorëve për të identifikuar mbajtjen e armëve të zjarrit pa leje	2022
	Të garantohet vendosja e masave ligjore që lejojnë legalizimin dhe dorëzimin vullnetar të armëve	Legalizimi përdoret në mënyrë sporadike së bashku me dorëzimin vullnetar; dorëzimi vullnetar kryesisht përdoret si masë në kohën e tranzicionit të ligjeve; mungesa e legjislacionit për dorëzimin vullnetar; mungesa e stimujve	2020

OBJEKTIVI	SYNIMET E PËRGJITHSHME	REFERENCA BAZË	AFATI KOHOR
OBJEKTIVI 5. *Brenda vitit 2024, të ulet mjaftueshëm numri i përllogaritur i armëve të zjarrit që mbahen në mënyrë të paligjshme në Ballkanin Perëndimor*	Përdorimi sistematik i çaktivizimit për të reduktuar zotërimin e paligjshëm të armëve të zjarrit	Disa përfitues kanë rregullore për çaktivizimin, por kanë praktika, kapacitete dhe zbatim jokonsistent dhe ato nuk janë në harmonizim të plotë me rregulloren e BE-së për çaktivizimin	2024
	Rritja e kapaciteteve administrative dhe informimit të synuar për të plotësuar riregjistrimin brenda kuadrit kohor të parashikuar me ligj, si edhe trajtimi i përshtatshëm i armëve të zjarrit të gjetura dhe të trashëguara	Zgjatja e periudhave të riregjistrimit pas ndryshimeve në ligjet për armët që çojnë në devijime të paligjshme të armëve	2020

6. SHKATËRRIMI FIZIK SISTEMATIK I AME-VE

Në Ballkanin Perëndimor ende ka sasi të konsiderueshme të AVL-ve/armëve te zjarrit të jashtëligjshme dhe municioneve. Prania e vazhdueshme e sasisë së tepërt dhe AME-ve të jashtëligjshme shërben në mënyrë të pashmangshme si faktor destabilizues në rajon dhe egziston gjithnjë rreziku i tregtisë së paligjshme.

Verifikimi i menjëhershëm dhe sistematik dhe shkatërrimi fizik i sasisë së tepërt të armëve të zjarrit, municioneve dhe eksplozivëve (AME) të konfiskuara është një veprimtari kyçe për ndalimin e përhapjes (d.m.th. ulja e rrezikut nga oferta në tregun e jashtëligjshëm).

Shkatërrimi i armëve të zjarrit trajtohet si çështje më vete nga shkatërrimi i municioneve dhe eksplozivëve, duke qenë se ajo është një veprimtari më e thjeshtë dhe më e sigurt se shkatërrimi fizik i municioneve. Shkatërrimi i municioneve dhe eksplozivëve është një detyrë e specializuar që duhet të kryhet në mënyrë të sigurtë, efikase dhe efektive nga një staf i trajnuar dhe i kualifikuar siç duhet dhe në një mjedis të përshtatshëm.

Udhërrëfyesi dhe synimet e tij për arritjen e këtij objektivi, kanë për qëllim të garantojnë uljen e stoqeve nëpërmjet shkatërrimit dhe çaktivizimit sistematik dhe fizik të sasisë së tepërt të AZME-ve të mbledhura ose të konfiskuara.

OBJEKTIVI	SYNIMET E PËRGJITHSHME	REFERENCA BAZË	AFATI KOHOR
OBJEKTIVI 6. *Ne mënyre sistematike, të ulet sasia e tepërt dhe të shkatërrohen armët e vogla dhe të lehta dhe municioneve të tyre të kapura*	Shkatërrimi sistematik i stoqeve të tepërta të AME-ve në një mënyrë jo të dëmshme për mjedisin	Egzistojne SOP-të për shkatërrimin; është kryer shkatërrimi periodik i armëve; shumica e përfituesve kanë poligone/mjedise ushtarake të certifikuara për shkatërrimin e municioneve; në disa përfitues mungon LCM-të (Manaxhimi i Jetes se Municioneve – Life Cycle Management) për municionet; të paktën një përfitues zotëron teprica të mëdha municionesh	2019 - 2024
	Shkatërrimi sistematik dhe publik i të gjitha AME-ve të konfiskuara	Egzistojne SOP-të për shkatërrimin në vend; shkatërrimi periodik i armëve me vendime gjykate; shumica e përfituesve kanë poligone/mjedise ushtarake të certifikuara për shkatërrim; shkatërrim periodik i municioneve me vendim gjykate	2019 - 2024

7. MENAXHIMI I STOQEVE - PËRMIRESIMI I RREGULLOREVE DHE MONITORIMI I PËRPUTHSHMËRISË

Menaxhimi i stoqeve është një term i gjerë, që përfshin por nuk kufizohet me udheheqjen dhe menaxhimin e stoqeve, përveç zonave teknike specifike të sigurisë së stoqeve.

Nëse nuk menaxhohen siç duhet, stoqet e AME-ve mund të përhapen, të përkeqësohen, të dëmtohen ose të krijojnë një rrezik të qenësishëm për sigurinë nëse nuk magazinohen, trajtohen dhe transportohen siç duhet.

Arritja e synimeve të përgjithshme për përmbushjen e këtij objektivi do të garantojë që autoritetet e Ballkanit Perëndimor të kryejnë menaxhimin e stoqeve në përputhje me standardet dhe praktikat e mira ndërkombëtare, duke garantuar kështu që autoritetet kombëtare kanë kapacitet të kryejnë, monitorojnë dhe zbatojnë monitorimin e stoqeve gjatë gjithë ciklit të jetës së AME-ve në lidhje me përgjegjësitë më të mëdha të menaxhimit.

OBJEKTIVI	SYNIMET E PËRGJITHSHME	REFERENCA BAZË	AFATI KOHOR
OBJEKTIVI 7. *Të ulet në mënyrë të konsiderueshme rreziku i përhapjes dhe devijimit të armëve të zjarrit, municioneve dhe eksplozivëve*	Fuqizimi i kapaciteteve të institucioneve të shteteve përkatëse (forcat e armatosura, institucionet ligjzbatuese, roja pyjore, doganat, shërbimet korrigjuese) për të ngritur sisteme inspektimi dhe për të zbatuar menaxhimin gjatë ciklit jetësor të AVL-ve/armëve te zjarrit dhe municioneve (sipas rastit)	Forcat e armatosura kanë plane inspektimi; standardet ndryshojnë; në disa përfitues janë përgatitur LCM, por ato nuk janë standardizuar	2020 - 2024
	Të garantohen mjedise magazinimi të sigurta për AVL-të/armët e zjarrit dhe municionet të përcaktuara sipas nevojave të identifikuara dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare	Nivel i ndryshëm sigurie në mjediset për magazinimin e AVL-ve/armëve te zjarrit dhe municioneve të tyre në të gjithë rajonin; analiza kosto-përfitim për mjediset e magazinimit të AVL-ve/armët e zjarrit dhe municioneve të tyre	2024

OBJEKTIVI	SYNIMET E PËRGJITHSHME	REFERENCA BAZË	AFATI KOHOR
OBJEKTIVI 7. *Të ulet në mënyrë të konsiderueshme rreziku i përhapjes dhe devijimit të armëve të zjarrit, municioneve dhe eksplozivëve*	Ngritja e kapaciteteve të subjekteve juridike përkatëse (prodhues, dyqane riparimi, dyqane shitjeje me pakicë, tregtuesit, poligonet e qitjes, poligonet e gjuetisë, shoqëritë private të sigurisë, qendrat e trajnimit) për të përcaktuar sistemet e inspektimit	Ekzistojnë kufizime ligjore dhe rregullatore minimale për dyqanet e riparimit; rregullore dhe mbikëqyrje minimale për prodhimin dhe tregtimin e lëndëve plasës për përdorim civil. Numer i larte nderrimi/largimi i personelit te specializuar; kapacitete te limituara trajnimi	2023
	Rritja e burimeve njerëzore dhe kapaciteteve administrative të institucioneve shtetërore për të monitoruar, mbikqyrur dhe vlerësuar stoqet e armëve të zjarrit dhe municioneve të subjekteve juridike dhe individëve	Një numër minimal njerëzish që merren me këto detyra; nuk ka vlerësim rreziku që kategorizon dhe vendos sipas përparësisë vizitat mbikëqyrëse dhe inspektuese në subjektet juridike dhe individët. Paga dhe vlerësim i ulët për menaxherët e Sigurisë Fizike dhe Menaxhimit të Stoqeve (PSSM)	2024

SEESAC
Bulevar Zorana Đinđića 64, 11070 Belgrade / SERBIA
seesac@undp.org
Office: +381 (11) 4155 368
www.seesac.org

@SEESAC
@UNDP_SEESAC
@undp_seesac

ROADMAP
FOR A SUSTAINABLE SOLUTION TO THE ILLEGAL POSSESSION, MISUSE AND TRAFFICKING OF SALW AND THEIR AMMUNITION
IN THE WESTERN BALKANS BY 2024